



Ju dëshironi të merrni pjesë në GESiK?

Është kënaqësi për ne që ju merrni pjesë në studimin tonë pilot. Ekzaminimi kryhet nga inspektoriati juaj shëndetësor. Ju lutemi shoqëroni fëmijën tuaj.

Të dhënat në lidhje me vendin dhe një propozim për orarin e takimit i gjeni në shkresën e inspektoriatit tuaj shëndetësor.

E rëndësishme! Ju lutemi njoftoni menjëherë inspektoriatin tuaj përgjegjës shëndetësor në numrin e telefonit ose adresën e E-Mail-it të dhënë në shkresë, nëse nuk mund të vini dot në takimin e lartpërmendur.

Vula e inspektoriatit shëndetësor:



www.lgl.bayern.de

Herausgeber: Bayerisches Landesamt für
Gesundheit und Lebensmittelsicherheit
Eggenreuther Weg 43, 91058 Erlangen
www.lgl.bayern.de
Internet:
E-Mail: poststelle@lgl.bayern.de
Telefon: 09131 6808-0
Telefax: 09131 6808-2102
Bildnachweis: Bayerisches Landesamt für
Gesundheit und Lebensmittelsicherheit, fotolia.com: Titelseite
(Fotolia.com@MNStudio), innen links (Fotolia.com@S.Kobold),
Rückseite links (Fotolia.com@svetaorlova)
Stand: August 2015
© LGL, alle Rechte vorbehalten

Diese Druckschrift wird kostenlos im Rahmen der Öffentlichkeitsarbeit der Bayerischen Staatsregierung herausgegeben. Sie darf weder von den Parteien noch von Wahlwerbenden oder Wahlhelfern im Zeitraum von fünf Monaten vor einer Wahl zum Zweck der Wahlwerbung verwendet werden. Dies gilt für Landtags-, Bundestags-, Kommunal- und Europawahlen. Missbräuchlich ist während dieser Zeit insbesondere die Verteilung auf Wahlveranstaltungen, an Informationsständen der Parteien sowie das Einlegen, Aufdrucken und Aufkleben parteipolitischer Informationen oder Werbemittel. Untersagt ist gleichfalls die Weitergabe an Dritte zum Zweck der Wahlwerbung. Auch ohne zeitlichen Bezug zu einer bevorstehenden Wahl darf die Druckschrift nicht in einer Weise verwendet werden, die als Parteinahme der Staatsregierung zugunsten einzelner politischer Gruppen verstanden werden könnte. Den Parteien ist es gestattet, die Druckschrift zur Unterrichtung ihrer eigenen Mitglieder zu verwenden. Bei publizistischer Verwertung – auch von Teilen – wird um Angabe der Quelle und Übersendung eines Belegexemplars gebeten. Das Werk ist urheberrechtlich geschützt. Alle Rechte sind vorbehalten. Die Broschüre wird kostenlos abgegeben, jede entgeltliche Weitergabe ist untersagt. Diese Broschüre wurde mit großer Sorgfalt zusammengestellt. Eine Gewähr für die Richtigkeit und Vollständigkeit kann dennoch nicht übernommen werden. Für die Inhalte fremder Internetangebote sind wir nicht verantwortlich.



BAYERN | DIREKT ist Ihr direkter Draht zur Bayerischen Staatsregierung. Unter Telefon 089 122220 oder per E-Mail unter direkt@bayern.de erhalten Sie Informationsmaterial und Broschüren, Auskunft zu aktuellen Themen und Internetquellen sowie Hinweise zu Behörden, zuständigen Stellen und Ansprechpartnern bei der Bayerischen Staatsregierung.



GESiK kontrollon shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës tuaj një vit para se të bëhet një fëmijë para-shkollor (pra në moshën rreth katër ose pesë vjeç) dhe zëvendëson ekzaminimin e pranimit në shkollë.

Përzgjedhja e testeve domethënëse dhe në përputhje me moshën lejon zbulimin e hershëm të vonesave në zhvillim dhe të efekteve negative shëndetësore. Shpesh gjëra të tilla ju mund ti trajtoni me shumë pak mundim.

Të gjithë fëmijët duhet të kenë mundësi të një shans të mirë për një fillim të suksesshëm të shkollës.

Informacione të tjera në internet:

Ekzaminimi shëndetësor dhe i zhvillimit në moshën e kopshtit (GESiK):
www.lgl.bayern.de/gesik



Ekzaminimet e pranimit në shkollë:
[www.lgl.bayern.de/ekzaminimet e pranimit në shkollë](http://www.lgl.bayern.de/ekzaminimet-e-pranimit-ne-shkollë)

Informacione të tjera (jo çështje që kanë të bëjnë me takimin)
Zyra e landit të Bavarisë për shëndetin dhe sigurinë e ushqimeve: Tel. 09131 6808-5132
E-Mail: Einschulung@lgl.bayern.de



Ftesa

për në ekzaminimin
shëndetësor dhe të
zhvillimit në moshën e
kopshtit (GESiK)



Ekzaminimi i pranimit në shkollë GESiK që kryhet më parë

Ekzaminimi i pranimit në shkollë për të gjithë fëmijët deri tani kryhet disa muaj para fillimit të shkollës.

Prej vitesh një gjë e tillë është provuar si e suksesshme. Por tani gjetjet e reja tregojnë që një ekzaminim më i hershëm ka avantazhe për fëmijët. Për këtë arsye si fillim në gjashtë njësi/komuna të përzgjedhura të Bavarisë do të aplikohet një ekzaminim i katër dhe pesëvjeçarëve (GESiK).

Njësia/komuna juaj do të marri pjesë, që do të thotë që ju dhe fëmija jua keni shansin të merrni pjesë në këtë ekzaminim të përmirësuar.

Është planifikuar që një gjë e tillë të aplikohet në të gjithë Bavarinë.

Pjesëmarrja në GESiK

Pjesëmarrja është me dëshirë. Nëse fëmija juaj merr pjesë tani, atëherë një gjë e tillë heq peshën nga familja në muajt plot emocione para fillimit të shkollës. Nëse nuk do të keni kohë duhet që ta dërgoni fëmijën tuaj vitin tjetër tek ekzaminimi i detyrueshëm i pranimit në shkollë. Gjatë këtij ekzaminimi do të përdoren të njëjtat procesi testimi, por duke përdorur vlerat kufizuese të përshtatshme për moshën përkatëse.



Avantazhet

- Në shumicën e rasteve çdo gjë është në rregull. Atëherë ju jeni i qetë dhe nuk do të ketë më takime të tjera për ju.
- Çrregullimet e shikimit dhe dëgjimit trajtohen me më shumë sukses dhe më shpejt sa më herët që të fillohet me terapinë.
- Nëse ekzistojnë vonesa të vogla në zhvillim ju mund ta ndihmoni vetë fëmijën tuaj duke e nxitur si dhe nëpërmjet ushtrimeve në formë lojë. Gjatë ekzaminimit juve do t'ju shpjegohet se si mund ta bëni një gjë të tillë.
- Nëse do të ishte e domosdoshme një nxitje e vazhdueshme ose një terapi ju dhe fëmija juaj keni edhe më shumë kohë.



Sa më herët të zbulohen problemet shëndetësore ose një zhvillim i vonuar, aq më mirë mund të trajtohen ato. Trajtimi i hershëm heq ngarkesën nga ju dhe nga fëmija juaj.

Ekzaminimi

Një **asistente social-mjekësore** shënon

- peshën dhe gjatësinë e fëmijës tuaj
- statusin e vaksinave dhe informacione nga „Fletorja e verdhë“

Ajo kontrollon me teste të përshtatshme për moshën dhe në formë loje

- aftësia e të shikuarit dhe të dëgjuarit
- aftësia gjuhësore dhe e të folurit, pra çfarë kupton fëmija juaj dhe si flet vetë
- aftësitë të cilat vlejnë si kusht për të mësuarit në shkollë (si për shembull „shumë“ dhe „pak“ ose „i madh“ dhe „i vogël“)

Ju do të merrni nga një pyetësor për historikun mjekësor dhe statusin e zhvillimit të fëmijës tuaj. Plotësimi është me dëshirë por deklaratimet formojnë një plotësim të rëndësishëm për rezultatet e ekzaminimit.

Ekzaminimi mjekësor

- Një ekzaminim mjekësor i mëvonshëm kryhet nëse gjatë ekzaminimit u konstatua diçka që bie në sy ose nëse ju si prindër e dëshironi një gjë të tillë.
- Nëse edhe gjatë ekzaminimit mjekësor ekziston dyshimi i një çrregullimi shëndetësor ose i një mos-zhvillimi jo në përputhje me moshën, atëherë mjeku/mjekja do të diskutojë së bashku me ju në mënyrë të detajuar veprimet e mëtejshme. Gjatë këtij diskutimi do të merren parasysh pikat e forta dhe talentet e fëmijës tuaj.
- Rezultati i bisedës do t'ju jepet juve me vete me shkrim. Nëse do të këshillohet një sqarim i mëtejshëm tek pediatri, mjeku i familjes ose mjeku i specializuar, atëherë ju do të merrni me vete një rekomandim me shkrim. Këtë mund ta paraqisni kur të shkoni atje.

Në momentin që GESiK ka përfunduar, ju do të merrni nga inspektoriat juaj shëndetësor një pyetësor informues për ta paraqitur në shkollë.

Të dhënat e vlerësuara gjatë ekzaminimit (pa mbiemër, ditëlindje, adresë ose numër telefoni) me miratimin tuaj i dërgohen zyrës së landit për shëndetësinë dhe sigurinë e ushqimeve (LGL) dhe vlerësohen atje në mënyrë statistikore.